



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 709/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkritazi me ankesat e Selatin Rizani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me seli në Prishtinë, dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN si të pabazuara ankesat e parashtruara nga Selatin Rizani, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Lipjan, nga radhët e subjektit politik Nisma për Kosovën, me shenjë ZL.Anr.709/2017, ZL.Anr.710/2017, ZL.Anr. 711/2017, ZL.Anr. 712/2017, ZL.Anr.713/2017 të datës 09.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it, ka pranuar ankesat ZL.Anr.709/2017, ZL.Anr.710/2017, ZL.Anr.711/2017, ZL.Anr.712/2017 dhe ZL.Anr.713/2017 me datën 09.11.2017 në ora 15:15, nga parashtruesi i ankesave Selatin Rizani, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal në Lipjan nga radha e subjektit politik NISMA, me seli në Prishtinë, dega Lipjan. Në apelet e parashtruara pretendohet se në vendvotimet 1322E, 1307/E, 126/E, 1324/E, 1304/E në Dobrajë, Gadime, Krajmir, Risinoc, në komunën e Lipjanit, nga komisionarët e vendvotimeve janë vjedhur votat. Kërkon nga PZAP-i që të rinumërohen votat në vendvotimet e cekura në ankesë.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur formularin e votave të kandidatëve.

Paneli, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me ZL.Anr.613/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për të tri ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës .

PZAP-i, pas shqyrtimit të besueshmërisë dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Paneli i PZAP-it, pas vlerësimit të pretendimeve në apele gjeti se apeluesit me asnjë provë bindëse nuk janë dëshmuar pretendimet e tij lidhur me parregullsitë dhe nuk i ka identifikuar se sa vota i mungojnë për vendvotimet me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi dhe keqpërdorime të votave. Prandaj, Paneli apelin e apeluesit e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apelet në fjalë janë të pabazuara dhe të pa argumentuara, me dëshmi konkrete andaj apelet i refuzoj si të pabazuara.

Nga sa u tha me sipër duke u bazuar në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

ZL.Anr.709/2017 më datën 12.11.2017.

Kryesuese e Panelit
Gjytene Sylajmani



Udhëzim Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*